

NË KËTË NUMËR

- PUBLIKOHEN TREGUESIT E TREMUJORIT TË PARË 2018
- ZHVILLOHET TRYEZA SEKTORIALE – TREGU I SIGURIMEVE DHE SHËRBIMI SHËNDETËSOR.
- PREZANTOHEN PRODUKTET E SIGURIMEVE NË UNIVERSITETIN “F.S.NOLI”, KORÇË.
- KRIJOHET KOMITETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.
- ZHVILLOHET MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHËSHME.
- SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË PËRFSHIHET NË PROJEKTIN “ PËR SIGURIMET VULLNETARE GJITHËPËRFSHIRËSE”.
- SIGAL UNIQA PREZANTON KONKURSION: “INOACIONI NË SIGURIME”.
- ALBSIG SHA MERR PJESË NË PANAIRIN E “DITËS SË KARRIERËS”



PUBLIKOHEN TREGUESIT E TREMUJORIT TË PARË 2018

Në Janar-Mars 2018 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 2.53%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 87,605 mijë lekë duke arritur shifrën 3,552,332 mijë lekë. Numri i kontratave arriti në 261,173 duke shënuar një ulje me 4.58% krahasuar me Janar-Mars 2017.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 3,306,339 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 3.54% krahasuar me Janar-Mars 2017.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 231,090 duke shënuar një rritje në masën 5.49% krahasuar me Janar-Mars 2017.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 241,547 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 4.43% krahasuar me Janar-Mars 2017.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 30,074 duke shënuar një rritje në masën 5.54% krahasuar me Janar-Mars 2017.

Gjatë Janar-Marsit 2018, janë paguar gjithsej 1,153,340 mijë lekë dëme ose 22.03% më pak se gjatë Janar-Marsit 2017.

Numri i dëmeve të paguara në Janar-Mars 2018 është ulur me 1,104 dhe arriti shifrën 10,516 nga të cilat 10,057 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 459 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

ZHVILLOHET TRYEZA SEKTORIALE – TREGU I SIGURIMEVE DHE SHËRBIMI SHËNDETËSOR.

Me datë 24 prill 2018, me iniciativë të Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes znj. Sonila Qato dhe me pjesëmarrjen e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale znj. Ogerta Manastirliu, u zhvillua Tryeza Sektoriale - Tregu i sigurimeve dhe shërbimi shëndetësor.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të tregut të sigurimeve, të qendrave spitalore jo-publike, etj.


Pjesëmarrësit në takim diskutuan mbi nivelin e ulët të prezencës së sigurimeve në shëndetësi, rrugët dhe mundësitë për zgjerimin e kësaj pjese të tregut, eksperiencat pozitive në rajon, etj.

Tryeza do të vazhdojë me diskutime në nivele teknike për të gjetur dhe realizuar zgjidhjet më të mira që i përshtaten shërbimit shëndetësor të vendit.

PREZANTOHEN PRODUKTET E SIGURIMEVE NË UNIVERSITETIN “F.S.NOLI”, KORÇË.

Në kuadër të fushatës sensibilizuese për edukimin e konsumatorit, me datën 16 Prill 2018, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Jetës, Pensioneve e Fondeve të Investimit zhvilluan një takim promovues me studentët e Universitetit “F.S.Noli” në Korçë. Në stendën e ngritur me këtë rast, u paraqitën materiale shpjeguese për produktet e sigurimit të ofruara nga kompanitë anëtare të shoqatave. Gjithashtu, z.Naim Hasa – Kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve e Fondeve të Investimit dhe znj. Agime Kastrati - menaxhere marketingu e ALBSIG Sha, ju përgjigjën interesit të studentëve mbi tregun e sigurimeve.

Promovojmë
praktikat dhe
standartet më të
larta në fushën
e sigurimeve,
në mbrojtje të
interesave të
konsumatorëve.



SHOQATA E SIGURUESVE TË
SHQIPËRISË

Rr. "Ibrahim Rugova",
Pall 21/4, Kati i dytë
Tiranë

Email: info@shoqatasiguruesve.al
www.shoqatasiguruesve.al

SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË PËRFSHIHET NË PROJEKTIN “ PËR SIGURIMET VULLNETARE GJITHËPËRFSHIRËSE”.

Në datat 24-26 prill 2018, në ambientet e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi Workshop-in e 2-të Kombëtar në kuadër të Projektit “ Për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse”, projekt i cili mbështetet nga partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë si edhe nga Iniciativa për Akses në Sigurime (Access to Insurance Initiative).

Në këtë projekt, që ka filluar në fund të vitit 2017 dhe do të zgjasë deri në Nëntor 2018, pjesëmarrësit janë përfaqësues nga shoqëritë e sigurimit në vend, banka, agjenci kreditimi si edhe organizma të tjerë që kanë aktivitet në fushën financiare dhe të biznesit.

Tashmë si pjesë e këtij projekti është edhe stafi i SHSSH-së, i cili në këtë workshop prezantoi një material në lidhje me mundësitë e implementimit të mikro-sigurimeve në bujqësi.



ALBSIG SHA MERR PJESE NË PANAIRIN E “DITËS SË KARRIERËS”



Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, nën moton “Hidh Hapin Tënd”, zhvilloi me datën 19 prill 2018 Panairin e “Ditës së Karrierës”, ku morën pjesë rreth 60 kompani të cilat ekspozuan ofertat e tyre të punës.

Pjesëmarrës në këtë veprimtari, shoqëria e sigurimeve Albsig sha - pjesë e “Kastrati Group”, bëri prezent për të pranishmit ofertat mbi mundësitë e punësimit,

trajnimet, internshipet, praktikat mësimore dhe workshopet.

Shoqëria Albsig sha është dalluar vazhdimisht si mbështetëse e brezave të rinj në rrugën e karrierës. Për të zhvilluar më tej aftësitë personale dhe profesionale të tyre në fushën e sigurimeve.

Stenda e Albsig sha u vizitua nga rreth 90 studentë, ku shumica prej tyre përveç kërkesave për internshipet kërkuan dhe mundësi praktikimi dhe punësimi.

Në kuadër të mbështetjes së studentëve pjesëmarrës në këtë panair, Albsig sha u mundësoi 10 prej studentëve më të mirë internshipin pranë departamenteve përkatëse të shoqërisë.

KRIJOHET KOMITETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.

Në kuadër të plotësimit të strukturave ndihmëse dhe funksionale të Shoqatës, me datë 28 Mars 2018 u zhvillua takimi organizues i Komitetit të Teknologjisë së Informacionit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha shoqëritë e sigurimit të jo-jetës.

Në mbledhjen e tij të parë, Komiteti zgjodhi Kryetar z.Leonard Fezollari dhe nënkryetar z.Klodian Maloku.

ZHVILLOHET MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME.

Asambleja e Përgjithëshme e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë zhvilloi në qytetin e Korçës, me datën 16 Prill 2018, mbledhjen e zakonshme të saj. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithëshme pasi diskutuan mbi problematikat që shqetësojnë sot tregun e sigurimeve të jo-jetës morën vendime të rëndësishme në lidhje me projekt-ligjin “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, për investimet në Qendrën e Informacionit, mbi ndryshimet e fundit në Rregulloren nr.53, datë 25.06.2009, etj.

SIGAL UNIQA PREZANTON KONKURSION: “INOACIONI NË SIGURIME”.

SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Universitetin European të Tiranës prezantoi konkursin “INOACIONI NË SIGURIME”. Për dy muaj, studentët do të ftohen të kryejnë kërkime dhe të propozojnë idetë e tyre novatore mbi tregun e sigurimeve në Shqipëri, sesi mund të zhvillohet ky treg, çfarë përmirësimesh teknologjike mund të ketë, si mundet të depërtohet tek klientët dhe të ndikohet në ndryshimin e mentalitetit të tyre mbi sigurimet.

Ky projekt u prezantua nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, Z. Avni Ponari, në një bashkëbisedim me studentët e UET dhe pedagogët e këtij universiteti.

Pas paraqitjes së ideve të tyre, do të përzgjidhen edhe idetë më të mira, të cilat do të zhvillohen nga ana e studentëve me kërkime konkrete apo me implementimin e programeve specifike, dhe në fund 3 idetë më të mira do të vlerësohen me çmime. Qëllimi i këtij konkursi është që brezat e rinj të njihen dhe edukohen me sigurimet, si një industri e domosdoshme për qytetarët.



ANËTARËT E SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

